

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.L. nga Gjilani, për shkak të veprës penale grabitje nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe V.H., gjithashtu nga Gjilani, për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale grabitje nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 33 të KPRK-së, duke vendosur për ankesën e mbrojtësit të akuzuarit V.H., av. M.M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.74/2018, të dt. 17.08.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, me datës 09.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.H., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.74/2018, të datës 17.08.2018, përkitazi me të akuzuarit V.H., VËRTETOHET.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.74/2018, të datës 17.08.2018, përkitazi me të akuzuarin F.L., mbetet i paprekur.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.74/2018, të dt. 17.08.2018, i ka shpallur fajtorë të akuzuarit, dhe atë: të akuzuarin F.L., për veprën penale grabitje nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa, të akuzuarin V.H., për vepër penale ndihmë në kryerjen e veprës penale grabitje nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 33 të KPRK-së, dhe për këto vepra penale i ka gjykuar: të akuzuarin F.L., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, nga data 19.03.2018 e gjer me datën 03.08.2018, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, ndërsa, të akuzuarit V.H., i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje

prej 7 (shtatë) muaj, në të cilin, po ashtu i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 19.03.2018 e gjer me datën 03.08.2018, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, dënime këto të cilat do të ekzekutohen menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa, dënimet me gjobë në afat prej 3 (tre) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nëse refuzojnë ta paguajnë dënimin me gjobë atëherë i njëjti do t'iu zëvendësohet me dënim burgu ashtu që një ditë burg do t'iu llogaritet në shumë prej nga 20 €.

Të akuzuarit i ka detyruar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç, të paguajnë shumën prej nga 30 (tridhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit V.S. av. M.M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë me burgim dhe me gjobë, apo të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të dëmtuarën, të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij av. M.M.. Në seancën e kolegjit nuk prezantoi askush nga palët edhe pse ishin të ftuar në mënyrë të rregullt, prandaj, gjykata seancën e mbajti pa prezencën e tyre konform dispozitave të nenit 390 par. 4 të KPPK-së.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.450/18, të dt. 27.09.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit V.H., av. M.M., aktgjykimi i shkallës së parë, kundërshtohet përveç vendimit për dënim edhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe shkeljes së Ligjit Penal, me arsyetim se aktgjykimi

i ankimuar është i pa kuptueshëm në kundërshtim me vetveten, se nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare, gjegjësisht, pretendohet se dispozitivi nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 370 par. 4 e lidhur me dispozitat e nenit 365 të KPPK-së, ndërsa, më tutje në arsyetim të ankesës, vazhdohet me përshkrimin e dispozitave ligjore të parapara sipas nenit 370 dhe 365, mirëpo, përkitazi me pretendimet në fjalë nuk thuhet asgjë konkretisht, gjegjësisht, nuk ceket se cilat janë ato veprime inkriminuese konkrete që i mungojnë dispozitivit e që do të ndikonin në plotësimin, gjegjësisht, mos plotësimin e elementeve objektive apo subjektive të veprës penale, për të cilën i akuzuari V.H., është shpallë fajtor dhe kuptohet, pa dhënë arsye më konkrete menjëherë në vazhdim konstaton se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat Gjykata e Apelit, është e obliguar edhe sipas detyrës zyrtare t'i vërejë, pra, pa cekë konkretisht cilat janë ato shkelje esenciale.

Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të cekura si me lartë nuk qëndrojnë, ngase, sikur që rezulton nga shkresat në lëndë, i akuzuari V.H., në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka pranuar fajësinë, për veprën penale që me aktakuzë i vihet në barrë dhe përkitazi me këtë trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë, konform dispozitave të nenit 246 e lidhur me nenin 248 të KPPK-së, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 326 të KPPK, përkitazi me pranimin e fajësisë dhe në rastin konkret edhe nga shkresat në lëndë, rezulton se në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës për çka përkitazi me këtë është pajtuar edhe trupit gjykues dhe as i akuzuari e as mbrojtësi i tij prezent nuk kanë paraqitur vërejtje sa i përket pranimit të fajësisë së të akuzuarit për të gjitha pikat e akuzës, për çka edhe rrjedh se gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar drejtë dispozitat e nenit 326 e lidhur me nenin 248 të KPPK dhe ka marr aktgjykim të ligjshëm-pra, në bazë të pranimit të fajësisë. Po ashtu dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk është konfuz dhe as i pa qartë, apo edhe në kundërthënie me arsyetimin, ngase, në dispozitiv janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë elementet e veprës penale, për të cilën i akuzuari edhe është shpallë fajtor, pra, i njëjti është përpiluar konform dispozitave të nenit 365 të KPPK-së. Gjithashtu, edhe përkitazi me arsyetimin, janë zbatuar dispozitat e nenit 370 par. 7ë të KPPK-së, për çka, edhe nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare, ngase, nuk ka prova me të cilat është vërtetuar gjendja faktike, ngase, sikur që u tha më lartë, në rastin konkret në këtë çështje penale-juridike i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe për një gjë të tillë është pajtuar edhe trupi gjykues, prandaj, konsiderohet se edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të plotë, nga se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, për çka edhe përkitazi me këtë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme, prandaj, kjo gjykatë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të pretenduara me ankesë.

Po ashtu aktgjykimi i ankimuar nuk përmban as shkelje tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit V.H., shkelje këto të cilat gjykata i vëren edhe sipas detyrës zyrtare konformë dispozitave të nenit 394 të KPPK, e që kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Gjendja faktike në këtë çështje penalo-juridike nuk ka qenë objekt i vlerësimit të kësaj gjykate nga se me ankesë nuk ka mund të kontestohet, pasi që i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë konformë nenit 326 par.4 të KPPK.

Pretendimet ankimore në drejtim të shkeljes së ligjit penal, për të cilat në arsyetim të ankesës më shumë flitet në drejtim të vendimit për dënim, e për çka kjo gjykatë do të deklarohet më detajisht tek baza ankimore vendimi për dënim, ndërsa, përkitazi me shkelje të ligjit penal në kuptim të kualifikimit juridik të veprës penale, edhe pse nuk thuhet asgjë konkretisht, kjo gjykatë konstaton se pretendimet ankimore në këtë drejtim nuk qëndrojnë, ngase, duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, gjë që nuk kontestohet as nga i akuzuari, i cili pra, ka pranuar fajësinë, pa dyshim që rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari V.H., është kryes i veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale grabitje nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 33 të KPRK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuse të përshkruara më detajisht si në dispozitiv, të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për sanksionin penale dhe gjetjet e gjykatës.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, janë të pa bazuara.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet vendimi për dënim nuk është i drejtë dhe as i ligjshëm, ngase, në rastin konkret gjykata nuk ka zbatuar drejtë dispozitat e parapara për vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, por, vetëm në mënyrë të përgjithësuar janë numëruar rrethanat në fjalë, pa bërë më parë një analizë e pastaj, vlerësimi i tyre, për çka, sidomos, nuk janë respektuar dispozitat e parapara për zbutje të dënimit nga neni 75 par. 1 nën par. 3 dhe nenit 76 të KPK-së, prandaj, propozon që me zbatimin e dispozitave në fjalë nga Gjykata e Apelit, të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e cekura si më lartë nuk qëndrojnë për arsye se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të akuzuarit në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse ka vlerësuar të gjitha rrethanat sikur që parashihen në dispozitat e nenit 73 të KPK, të cilat kuptohet i pranon edhe kjo gjykatë. Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit nuk theksohet ndonjë rrethanë tjetër posaçërisht lehtësuese, përveç, që përsëriten ato që gjykata e shkallës së parë, i ka pasur parasysh, pra, edhe ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë ligjor, pra, nuk cekën rrethana tjera që do të ndikonin në zbutjen e mëtutjeshme të dënimit, sikur që pretendohet nga mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e cekura nga gjykata e shkallës së parë, rrethanat e rastit konkret, mënyrën e kryerjes së veprës penale, Gjykata e Apelit konsideron se pikërisht si rezultat i zbatimit të dispozitave të nenit 75 dhe 76 të KPK-së, gjykata e shkallës së parë, edhe i ka

shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë ligjor, për çka, edhe konsideron se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, ta bëjë rehabilitimin e tij si dhe të ndikoj tek personat tjerë nga kryerja e veprave penale, duke konsideruar kështu se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar do të arrihet qëllimi i dënimin të paraparë në dispozitat e nenit 41 të KPK.

Nga sa u tha më lartë e konformë dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.474/2018, të dt. 09.11.2018

Procesmbajtësi,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

1.Xhevdet Abazi

2.Have Haliti

Kryetari i kolegjit,
Abdullah Ahmeti